



BULETINI

Tetor 2009

Numri 8/2009

Përmbajtja

- Trajnim i trajnuesve IGJK-NCSC
- Trajnim i stafit të IGJK-së, NCSC/USAID
- Trajnim: E drejta e BE-së Acquis—communitare IGJK & EULEX
- Tryezë diskutimesh: Rishikimi i procedurës penale
- Tryezë diskutimesh: Trafikimi me njerëz
- Tryezë diskutimesh: Kompensimi i dëmit.
- Seminar: Kodi Penal i Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës IGJK & US DOJ
- Tryezë diskutimesh: Tryezë për gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje “ Ligji mbi sigurinë e komunikacionit rrugor”
- Kodin e Etikës (Regjioni i Gjilanit) IGJK & NCSC
- Tryezë pune: Dëgjimi i dëshmitarit në procedurën penale
- Tryezë pune: Roli dhe rëndësia e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës

ZHVILLIM
PROFESIONAL
GJYQËSOR

Adresa: Lagja e Spitalit, Rr. “Muharrem Fejza” p.n.
Prishtinë, Republika e Kosovës Tel&fax:
+381 (0) 38 512 069 +381 (0) 38 512
081 +381 (0) 38 512 095
www.kjijudicial.org info@kjijudicial.org

Trajnim i trajnuesve IGJK-NCSC

Më 01 - 02 tetor 2009, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me USAID/NCSC-Programi për Mbështetje Sektorit të Drejtësisë në Kosovë, realizoi një sesion trajnimi të nivelit të avancuar për trajnuesit e IGJK-së. Në kuadër të këtij trajnimi, trajnuesja ndërkombëtare me përvojë në këtë lëmi prezantoi njohuritë më të avancuara të përdorimit të metodave të ligjërimit, siç është zhvillimi i diskutimit interaktiv, puna në grupe dhe demonstrimi i metodologjive bashkëkohore të prezantimit. Qëllimi i

i këtij trajnimi ishte ngritja e nivelit të aplikimit të teknikave dhe metodave moderne gjatë prezantimit të çështjeve profesionale tek një audiencë profesionale. Si shembull i aplikimit praktik të këtyre teknikave dhe metodave, gjatë këtij trajnimi u realizuan prezantime konkrete nga ana e trajnuesve të IGJK-së, duke i zbatuar së paku tri prej metodave vizuale, të prezantuara gjatë sesionit në fjalë. Përfitues të trajnimit ishin trajnuesit e IGJK-së.

Trajnim i stafit të IGJK-së, NCSC/USAID



Më 06 tetor 2009, Instituti Gjyqësor i Kosovës, në mbështetje të USAID/NCSC, ka mbajtur një sesion të veçantë trajnues për stafin e institutit. efektive të detyrave dhe ngritjen e efikasiteti në punë. Përmbajtja

kryesore e këtij trajnimi kishte për qëllim ngritjen e shkathhtësive profesionale, përmbushjen efektive të detyrave dhe ngritjen e efikasiteti në punë. Temat të cilat u diskutuan gjatë këtij trajnimi, kryesisht u përqendruan lidhur me përmbushjen e detyrave në baza ditore, menaxhimin e kohës, punën ekipore si dhe konceptin e të qenit kreativ gjatë punës. Shtesë kësaj, secilit anëtarë të stafit ju dha mundësia për paraqitjen e propozimeve të tija/saja që do t'i kontribuonin zhvillimit të mëtejshëm të Institutit Gjyqësor të Kosovës. Përfitues të trajnimit ishte i tërë personeli i Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Trajnim: E drejta e BE-së Acquis – komunitare IGJK & EULEX

Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me EULEX-in, me datën 06,07,08 dhe 09 tetor 2009, realizoj një trajnim katër ditor, me ç'rast u shqyrtuan tema të ndryshme nga e drejtë e BE-se-Acquis communautaire. Gjatë këtyre sesioneve trajnuese nga gjyqtarë, prokurorë dhe ekspert ligjorë të EULEX-it, janë trajtuar shumë çështje specifike që lidhen me; nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, E Drejta Kontraktuese e BE-së dhe dhjetë prioritet e sajë, të drejtat e punësimit dhe çështjet sociale. Vëmendje e veçante iu kushtua edhe ndihmës së ndërsjellë juridike në aspektin penal të së drejtës së BE-së, legjislacionit për të drejtat e njeriut në lidhje me përgjimin, masave të fshehta, aspekteve institucionale të Ligjit Penal të BE-së, Shtyllave të

Shtyllave të BE-së “*Passerelle*”, Traktatit të BE-së si dhe çështjeve të Drejtësisë për të Mitur. Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor të Kosovës.



Tryezë diskutimesh: Rishikimi i procedurës penale



Më datë 13 tetor 2009 u organizua tryeza e diskutimeve nga lëmia penale me temë: “Rishikimi i procedurës penale”. Temat të cilat u shtjelluan gjatë këtij sesi trajnues kryesisht u përqendruan në trajtimin e çështjeve rreth sqarimit praktik të kushteve ligjore që duhet plotësuar për rishikim të procedurës me qëllim të ndryshimit të aktgjykimit të formës së prerë në procedurën penale. Paraprakisht, gjatë trajnimit u analizuan raste të ndryshme nga praktika gjyqësore si dhe u bë shkëmbimi i përvojave me qëllim të evitimit të problemeve praktike me synim eliminimin e tyre. Përfitues të trajnimit ishin gjyqtar prokuror nga të gjitha regjionet e Kosovës

Tryezë diskutimesh: Trafikimi me njerëz

Më datë 15 tetor 2009 u organizua një tryezë e diskutimeve nga lëmia penale me temë: “Trafikimi me Njerëz”. Gjatë këtij sesi trajnues u shtjelluan çështje të cilat kishin të bënin kryesisht me konceptet e identifikimit të veprave penale të trafikimit me njerëz, efektet dhe natyrën juridike të këtyre veprave, dallimin e trafikimit me njerëz nga vepra penale të ngjashme si dhe u shtruan për diskutim disa forma të mbrojtjes së viktimave që kanë qenë objekt i trafikimit. Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës



Tryezë diskutimesh: Kompensimi i dëmit

Më datën 20 tetor 2009 u mbajt një seminar nga lëmia civile lidhur me kompensimin e dëmit. Në këtë sesion trajnimi objekt trajnimi ishin; kriteret me ndikim në caktimin e lartësisë së shpërblimit për disa forma të dëmit material, sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësive (rastet e përgjegjësive subjektive dhe efektet për dëmet që pëson pala e tretë si dhe statusi i palës së tretë në disa raste specifike) dhe sigurimi nga auto përgjegjësia në Kosovë. Qëllimi i kësaj tryeze ishte ofrimi i njohurive përmbajtësore dhe harmonizimi i qëndrimeve juridike lidhur me kriteret dhe standardet të cilat do të aplikoheshin në rastet kur praktikisht vendoset për çështjet e kompensimit të dëmit. Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtorë profesional nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Seminar: Kodi Penal i Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës IGJK & US DOJ



Më 21 tetor 2009, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Drejtësisë së SHBA-ve OPDAT zyra në Prishtinë,

organizoj tryezën e diskutimeve lidhur me Përgatitjen dhe Hartimin e Aktakuzës. Sesioni në fjalë u prezantua nga z. Robert Higdon Zëvendës Prokurorë i SHBA-ve, Shef i Divizionit Penal, Qarku Lindor i Karolinës Veriore, i cili paraqiti pikat kryesore të procesit të hartimit të aktakuzës, përmbajtjen e saj dhe procedurën e konfirmimit në gjykatë. Vëmendje e posaçme iu kushtua krahasimit të Kodit dhe Procedurës Penale të Kosovës me atë të SHBA-ve, me theks të veçantë u trajtua roli i prokurorit në procedurë, të drejtat e të pandehurit, veçimit dhe bashkimit të procedurës, veprimet hetimore si dhe sistemin federal. Përfitues të këtij sesiioni trajnues ishin: gjyqtarët,

Tryezë diskutimesh: Tryezë për gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje “ Ligji mbi sigurinë e komunikacionit rrugor”

Më datë 22 tetor 2009 u mbajt një tryezë e diskutimeve nga lëmia e kundërvajtjeve me temë Veprat kundërvajtëse në komunikacionin rrugor me theks të veçantë për aksidentet e trafikut. Gjatë kësaj tryeze u bë një vështrim i shkurtër lidhur me; risitë dhe mangësitë e Ligjit të ri për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor; shqyrtimin e rasteve të ikjes nga vendi i aksidentit të personave të mitur, analiza e aksidenteve rrugore si dhe struktura e ekspertizës si provë e rëndësishme për vërtetimin e gjendjes faktike. Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët për kundërvajtje dhe policia e Kosovës nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Më 27 tetor 2009, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me USAID/NCSC, realizoi sesionin trajnues me temë “Etika e Gjyqësore dhe Prokuroriale në Kosovë. Temat të cilat u shtjelluan gjatë këtij sesiioni trajnues kryesisht janë përqendruar në analizimin e vlerave që janë paraparë me Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë dhe Prokurorë, duke ofruar sqarime të nevojshme rreth parimeve të cilat janë të obligueshme për gjyqtarët dhe prokurorët. Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e nivelit të vlerave etike, me synim të arritjes së standardeve për një sjellje sa më etike dhe më të dinjitetshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë. Sesiioni në fjalë u zhvillua nga njëri prej trajnuesve të specializuar dhe me përvojë të gjatë në këtë lëmi, nga

SHBA-të, në bashkëpunim me dy trajnues vendor, gjatë të cilit luajtja e roleve dhe diskutimi interaktiv dominuan.



Tryezë pune: Dëgjimi i dëshmitarit në procedurën penale



Më 28 tetor 2009, u organizua një tryezë pune nga lëmia penale. Temat të cilat u shtjelluan gjatë këtij trajnimi kryesisht janë përqendruar në disa çështje të diskutueshme në praktikën e dëgjimit të dëshmitarit në procedurën penale dhe u analizuan disa specifika që duhet pasur parasysh me atë rast. E veçanta e këtij trajnimi ishte diskutimi i disa rasteve praktike dhe prezantimi i përvojave të ndryshme të cilat për qëllim kryesor kishin eliminimin e vështirësive të cilat po shfaqen në praktikë. Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regjionit e Kosovës.

Tryezë pune: Roli dhe rëndësia e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Më 29 tetor 2009, është organizuar një seminar kushtuar të drejtës kushtetuese. Temat të cilat u shtjelluan gjatë këtij seminary kryesisht u përqendruan në çështjet që kanë të bëjnë me: Rolin dhe fushëveprimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe procedurat për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave pranë Gjykatës Kushtetuese. Në cilësi të prezantuesve në këtë seminar ishin gjyqtarë nga Gjykata Kushtetuese, ndërsa përfitues ishin gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatave të qarkut dhe gjykatave komunale.



